

RREGULLORE NR. 2008/11

**PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI EMRAT PERSONAL I MIRATUAR
NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP),

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh komunikatën nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, të datës 4 dhjetor 2007, përkitazi me Ligjin për emrat personal të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 13 prill 2007,

Duke ditur se dispozitat e Ligjit nuk e cenojnë pushtetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999) ose kompetencat e tij të rezervuara dhe përgjegjësitë sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall Ligjin për emrat personal të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 02/L-118) i cili i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje dhe hyn në fuqi në datën e nenshkrimit, me kusht që:

(a) Neni 6.2 të fshihet. Paragrafi pasues rinumërohet në mënyrë të duhur.

(b) Neni 9.4 ndryshohet si vijon:

“Emri personal në regjistrin civil përkatës dhe në dokumentet tjera publike shkruhet me shkronja dhe shenja të përcaktuara me ligjin në fuqi në Kosovë.”

(c) Neni 17 i shtohet një paragraf i ri me këtë formulim:

“17.4 Personi që ndryshon emrin është i obliguar të ndërmerr veprime të domosdoshme që emri i ndryshuar të paraqitet në dokumentet personale duke përfshirë edhe letërnjoftimin dhe dokumentin e udhëtimit. Regjistri civil ia përcjell emrin e ndryshuar autoriteteve përkatëse”.

- (d) Në nenin 18.2, fjala “gabimisht” futet para fjalës “ndryshuar”.
- (e) Në nenin 20 shtohet një paragraf i ri dhe do të ketë këtë formulim:

“20.3 Personi që ndryshon emrin është i obliguar të ndërmerr veprime të domosdoshme që emri i ndryshuar të paraqitet në dokumentet personale duke përfshirë letërnjoftimin dhe dokumentin e udhëtimit. Regjistri civil ia përcjell emrin e ndryshuar autoriteteve përkatëse”.
- (f) Titulli i nenit 22 “Dispozitat ndëshkuese” zëvendësohet me “Sanksionet administrative”.
- (g) Në nenin 24, fjala “gjobat” zëvendësohet me fjalët “Sanksionet administrative”.
- (h) Neni 25 fshihet.

Këto ndryshime paraqiten në tekstin përfundimtar të Ligjit.

Nënshkruar më 22 shkurt 2008.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm